



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.15.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Suharekës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Astrit Bllaca, i mbështetur nga Fikret Ibrahim (udhëheqës ekipi), dhe Senver Morina.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	28
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	29
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	32


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Suharekës për vitin 2015 - i cili e përcakton opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet e Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 02.11.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


“Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse auditimi ynë ka identifikuar keqklasifikime në llogaritë e PVF-ve në vlerën totale prej 227,368€, por të cilat ishin të aprovuara me buxhet. Po ashtu, ka paqartësi në prezantimin e plotë të llogarive të arkëtueshme si dhe pagesat nga palët e treta në vlerë 155,121€, nuk janë paraqitur në pasqyra financiare.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi të nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm, i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha, por dobësitë ende janë të pranishme në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



## Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### PËR KOMUNËN E SUHAREKËS

#### OPINION I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

#### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Theksimi i çështjes**

Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve në vlerë totale 227,368€, prej të cilave: 63,250€ janë paguar nga buxheti i Investimeve Kapitale për marrëveshjen me SHAK "Elena-Dora D'Istria", në emër të bursave për studentë, si dhe 21,120€ për mirëmbajtje të rrugëve. Këto shpenzime duhej trajtuar si shpenzime për mallra dhe shërbime dhe subvencione. Përveç kësaj, komuna kishte paguar edhe 142,998€, nga kategoria investime kapitale për Handikos bazuar në një marrëveshje mirëkuptimi, por ky shpenzim ndërlidhet me shërbime të kujdesit primar shëndetësor. Vlen të sqarohet se shumatat e keqklasifikuara prej 227,368€, ishin të aprovuara me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Komuna, gjithashtu, kishte prezantuar në PFV vlerën e llogarive të arkëtueshme më të vogël për 798,000€ se vlera reale e këtyre llogarive. Ky prezantim i gabueshëm kishte ardhur si gabim teknik gjatë hartimit të PFV dhe nuk ka efekte financiare për komunën dhe të hyrat komunale, si dhe pagesat nga palët e treta nuk janë paraqitur tek pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme në vlerë 155,121€. Ne nuk e kemi kualifikuar opinionin për çështjet e theksuara më lart.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme si dhe është përgjegjës për kontrollin brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga



mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

### 1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

#### **Përshkrimi**

Në memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 02.11.2015, është identifikuar një (1) rrezik për PVF-të. Ky rrezik është rrezik i keq pohimeve materiale, i cili mund të rezultojë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Ky rrezik ka të bëjë me klasifikimin e shpenzimeve, i cili ishte materializuar sepse nga menaxhmenti nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për të adresuar këtë rrezik.

Pagesat për marrëveshjen me SHAK “Elena-Dora D’Istria” bursa për studentë 63,250€ si dhe për mirëmbajtje të rrugëve në vlerë prej 21,120€, janë paguar nga buxheti i Investimeve Kapitale. Këto shpenzime janë regjistruar gabimisht si investime kapitale, dhe si të tilla, duhej trajtuar si shpenzime për mallra dhe shërbime dhe subvencione.

Gjithashtu, vlen të përmendet se pagesa në vlerë 142,998€, bazuar në marrëveshje për mirëkuptim ishte bërë nga kategoria investime kapitale për Handikos, por ky shpenzim ndërlidhet me shërbime të kujdesit primar shëndetësor. Të gjitha pagesat e kryera më lart, ishin të parashikuara me tabela buxhetore të Buxhetit 2015, ndonëse në kode jo adekuate.

Poashtu gjatë auditimit të PVF është identifikuar rreziku i mos prezantimit të pagesave nga Palët e Treta në PVF të komunës. Ky rrezik i keqdeklarimit material ka të bëjë me mos prezantimin e pagesave nga palët e treta tek pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, në vlerë 155,121€

## 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me kornizën raportuese.

Tek pasqyrat, përveç gabimeve të paraqitura tek rreziqet domethënëse, është identifikuar gabimi si në vijim:

- Llogaritë e arkëtueshme në PFV 2015 kanë një diferencë prej 798,000€ kur krahasohen me të hyrat e arkëtuara gjatë vitit aktual. Pas konsultimeve me zyrtarët e komunës është gjetur se kjo diferencë në PFV është gabim teknik dhe diferenca e njëjtë nuk ka efekte financiare ndërkohë që është korrigjuar dhe do të sqarohet në PFV vijuese.

Të gjeturat më lart dhe në kapitullin rreziqet domethënëse në PVF, tregojnë që përgatitja e PVF-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët.

### DEKLARATA E BËRË NGA KRYETARI I KOMUNËS

Marrë parasysh çfarë u tha më lartë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, nuk mund të konsiderohet plotësisht e saktë, për shkak të mangësive të identifikuara më lart, por që nuk konsiderohen materiale.

## 1.5 Rekomandimet

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale.

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo reflekton përkushtimin e menaxhmentit për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të mbështeten nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes në komunë, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut, zbatimin e objektivave strategjike dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit, duhet dukshëm të përmirësohen.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të komunës ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, katër (4) rekomandime janë implementuar, katër (4) janë në proces adresimit dhe gjashtë (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Raporti i auditimit të vitit 2014, ishte diskutuar edhe në Asamblenë Komunale.

---

### Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm katër rekomandime të vitit të kaluar ishin implementuar, sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

**Rreziku** Dobësitë e përsëritura të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare dhe fushat tjera të veprimtarisë kanë rezultuar në:

- Planifikim dhe ekzekutim të dobët të buxhetit;
- Mungesë e raporteve kthyesë lidhur me subvencionet e shpërndara;
- Mbi/nën vlerësim të shpalosjeve në pasqyra; dhe
- Dobësi në qeverisjen e përgjithshme.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike zbatimin e planit të veprimit dhe të identifikoj arsyet pse i njëjti nuk është zbatuar. Plani i hartuar pas pranimit të këtij raporti, duhet të përcaktoj saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve, dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri nga ana e komunës, dhe kemi vlerësuar disa pyetje kyçe për komponentët e listës kontrolluese. Gjetjet tona i kemi përmbledhur më poshtë. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por pasqyron gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. Komuna nuk ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik edhe pse në pyetësorin e vetëvlerësimit ishte cekur se ekziston Plani Zhvillimor Strategjik dhe është kalkuluar kosto e këtij plani; dhe
3. Udhëheqësit e njëjësive përgatisin raportet tre mujore për Kryetarin dhe Kuvendin Komunal. Takimet mbahen në baza të rregullta, por nuk ka dëshmi në dispozicion për të konfirmuar se në këto takime përcaktohen formalisht hapat për të adresuar çështjet e ngritura;

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

**Rreziku** Mungesa e një planifikimi strategjik dhe aranzhimet tjera të dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Një rol ndihmës në ngritjen e cilësisë dhe konfirmimit të pohimeve në pyetësorin e vetëvlerësimit, mund të ofroj auditimi i brendshëm përmes rishikimit përfundimtar.

---

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

#### Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka rikonfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla, nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.

## 2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 4 – Dobësi në Kontrollat Menaxheriale – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Raportimet ndaj menaxhmentit të lartë nuk ishin të formalizuara dhe dokumentuara në mënyrë të kënaqshme. Kjo është edhe arsyeja pse ne nuk jemi mbështetur në kontrollet në nivele të larta të menaxhmentit, sepse nuk ishim në gjendje të verifikonim nga procesverbalet e takimeve të kryetarit, masat e ndërmarra dhe diskutimet e bëra.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, rezultojnë në kontrolle të dobëta, dobësi në procesin buxhetor, reduktojnë mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë, si dhe potencialisht rezultojnë me humbje financiare.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura mbi Drejtorinë e komunës dhe të implementojë aranzhime më të mira për arritjen e objektivave të specifikuar dhe për të përmirësuar qeverisjen e mirë në të gjithë komunën.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Plani vjetor i punës së NJAB për vitin 2015 ishte hartuar bazuar në planin strategjik 2015-2017. NJAB ka planifikuar gjatë vitit 2015 të kryej 6 (gjashtë) auditime dhe nuk ka pasur devijime nga ky plan. Të gjitha auditimet janë përfunduar me kohë dhe gjatë kësaj faze ishin mbuluar disa nga fushat kryesore.

---

### Çështja 5 - Mos implementimi i rekomandimeve të NJAB - Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB: <ol style="list-style-type: none"><li>1. Menaxhmenti nuk ka përgatitë plane konkrete për implementimin e rekomandimeve të NJAB;</li><li>2. Komiteti i Auditimit nuk ka qenë shumë aktiv sa i përket rolit të vet. Asnjë herë nuk është bërë përpjekje të kërkohet nga menaxhmenti që të adresoj rekomandimet e dhëna nga NjAB; dhe</li><li>3. Gjatë vitit 2015, NJAB ka dhënë gjithsej 70 rekomandime 18 prej të cilave kishin afatin e implementimit vitin 2016, ndërsa 9 janë adresuar plotësisht, 30 janë adresuar pjesërisht, derisa 13 nuk janë adresuar ende.</li></ol>
<b>Rreziku</b>	Mungesa e planeve nga departamentet e audituara për të implementuar rekomandimet e dhëna, ndikon në mos korrigjimin dhe vazhdimin e mangësive dhe dobësive në proceset ku ato janë të pranishme.
<b>Rekomandimi 6</b>	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë nevojën që planet e auditimit të brendshëm të përshtaten me kërkesat që auditimi i brendshëm të ndjekë aktivitetet gjatë vitit aktual dhe që planet e veprimt të hartohen nga të gjitha njësitë e audituara në mënyrë që rekomandimet e dhëna të implementohen. Gjithashtu, kërkohet një rol më aktiv i Komitetit të Auditimit.



## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Komuna e kupton rëndësinë e sistemit të kontroleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, të hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës (procedura standarde të operimit) të cilat sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve vendore, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>13,561,333</b>	<b>14,375,360</b>	<b>13,587,676</b>	<b>12,948,970</b>	<b>12,719,099</b>
Granti i Qeverisë-Buxheti	11,444,133	11,658,548	11,617,542	11,511,488	10,286,473
Të bartura nga viti paraparak <sup>2</sup>		580,453	564,518	242,814	1,215,673
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	2,117,200	2,117,200	1,389,739	1,194,668	1,216,459
Donacionet e brendshme		465	465	0	0
Donacionet e jashtme		18,693	15,412	0	494

Në vitin 2015, janë shpenzuar 95% të buxhetit final me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2014. Pasqyra e mëposhtme është prezantuar pa konsideruar keq klasifikimet e identifikuara të paraqitura tek rreziku domethënës.

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të pashpenzuara të komunës në vitin paraparak dhe të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>13,561,333</b>	<b>14,375,360</b>	<b>13,587,676</b>	<b>12,948,970</b>	<b>12,719,099</b>
Pagat dhe Mëditjet	7,450,000	7,759,732	7,759,732	7,061,677	6,052,770
Mallrat dhe Shërbimet	874,850	931,965	913,344	921,359	888,926
Shërbimet komunale	207,000	209,910	209,235	227,360	232,194
Subvencionet dhe Transferet	280,999	287,215	286,746	298,120	204,581
Investimet Kapitale	4,748,484	5,186,538	4,418,619	4,480,454	5,340,628

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Planet buxhetore finale për Investime Kapitale në Komunën e Suharekës për vitin 2015 ishin 5,186,538€, prej të cilave janë realizuar 4,418,619€. Pavarësisht rritjes së buxhetit për projekte kapitale gjatë vitit, 85% e buxhetit ishte shpenzuar.
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 309,732€, është rezultat vendimit të Qeverisë për mbulimin e 0.5% të përvojës së punës.
- Po ashtu, buxheti i komunës ishte shpenzuar edhe përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga Thesari në vlerë prej 517,804€.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - pranimi krahas buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,117,000	2,117,000	1,816,000	1,632,052	1,453,778

Realizimi i të hyrave në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2015 ishte 86%. Të hyrat vetjake, të bartura nga viti 2014 dhe inkasimet e vitit 2015 ishin shpenzuar në total 1,954,257, dhe si rezultat i kësaj, një shumë e konsiderueshme prej 442,196€ ishte bartur për vitin 2016.

## 3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Gjatë vitit 2015 në total janë zbatuar 174 procedura të prokurimit në vlerë prej 4,238,662€.

---

### Çështja 6 - Dobësitë në blerjet përmes prokurimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Çmimi i blerjes së naftës me 'Premium' për blerjet gjatë vitit 2015 nuk ishte kalkuluar si duhet pasi që çmimi i transportit nuk ishte kalkuluar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. QRK 04/2014 për Përcaktimin e Shpenzimeve të Kostos së Transportit të Mallrave të Importuara.

Në 15 mostra të testuara, faturat ishin paguar jo në harmoni të plotë me rregullat financiare. Në disa raste faturat ishin paguar me vonesë, urdhërblerja ishte lëshuar pas pranimit të faturës, faturat nuk ishin nënshkruar nga Blerësi - komuna, furnizimet ishin sipas faturës, dhe jo sipas fletëdërgesës, ndërsa pagesat kryesisht janë çertifikuar pa ofertë financiare bashkangjitur faturave.

Nga mostrat tona kemi vërejtur vonesa në realizimin e projekteve prej 53 ditë vonesë për kontratën 'Asfaltimi i rrugës lagja e Palushëve' për situacionin e paguar 45,375€. Vonesa prej 46 ditë për kontratën 'Asfaltimi i rrugës lagja e Sopve - Grajqevc' për situacionin e paguar 60,000€. Vonesa prej 34 ditë për kontratën 'hartimi dhe revidimi i projekteve-Lot 3', ishte planifikuar të bëhet për 35 ditë nga data e nënshkrimit më 07.04.2015 por e njëjta ishte bërë me 10.07.2015. Vonesa prej 39 ditë për kontratën 'rregullimi i rrugëve lokale në Studenqan', në vlerë prej 109,647€ ishte planifikuar të bëhet për 42 ditë nga data 25.05.2015 por e njëjta nuk ishte përfunduar ende sipas raportit të pranimit me datën 14.09.2015.

**Rreziku** Pagesa e furnizimeve pa kontrolle përkatëse është në kundërshtim me LPP dhe njëherit e rritë rrezikun e humbjeve të parasë publike dhe që komuna të mos paguaj vlerat e sakta për furnizimet e pranuar. Përpilimi i Urdhërblerjes pas pranimit të faturës rrit rrezikun që fondet mos të jenë në dispozicion. Mos aplikim i penaleve për vonesat në përmbushje të kontratave e rritë rrezikun që projektet të mos kryhen me kohë dhe të mos arrihen objektivat e komunës.

---

**Rekomandimi 7** Kryetari duhet të inicoj një shqyrtim të hollësishëm të të gjitha rasteve të përmendura më lartë për të analizuar pse kërkesat ligjore dhe rregullat e prokurimit nuk janë zbatuar dhe të merr masa përgjegjësie ndaj personave që mund t'i kenë shkaktuar komunës humbje të konsiderueshme financiare. Gjithashtu, duhet vlerësuar pse kontrollet e certifikimit kanë dështuar në parandalimin e pagesave të parregullta, siç ishte rasti me pagesat e derivateve dhe blerjeve pa kontratë.

### 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë shpenzimet për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me komunalitë, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat me bashkëfinancim.

---

#### Çështja 7 - Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me OJQ në kundërshtim me rregulloret në fuqi - prioriteti i lartë

**E gjetura** Kryetari kishte nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me OJQ "Handikos" për projektin 'Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore në Suharekë' në vlerë 120,000€ dhe 22,800€. Komuna gjatë vitit 2015 kishte paguar 142,988€ nga kategoria Investime Kapitale. Komuna nuk kishte mbikëqyrje në realizimin e projektit të bërë me bashkëfinancim për t'u siguruar nëse paratë e shpenzuara ishin bërë në pajtim me objektivat e marrëveshjes.

Kryetari kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me SHAK "Elena-Dora D'Istria" për projektin "Ndarja e bursave për student dhe nxënës të Komunës së Suharekës" në vlerë 68,250€. Me këtë marrëveshje komuna obligohet të paguaj shumën prej 63,250€ dhe SHAK "Elena-Dora D'Istria" të kompensoj pjesën tjetër prej 5,000€. Komuna gjatë vitit 2015 kishte paguar 63,250€ nga kategoria Investime Kapitale, ndërsa bashkëfinancuesi nuk kishte paguar pjesën tjetër prej 5,000€ sipas marrëveshjes. Komuna kishte përgatitur një raport ku janë përfshirë vetëm listat e emrave për 100 studentë përfitues të bursës komunale prej 500€, dhe 53 studentë përfitues të bursës komunale prej 250€, ndërsa konkursi i shpallur me datën 20.11.2014 ishte për 100 studentë dhe 50 nxënës gjithsej 150 bursa. Komuna nuk kishte prezantuar ndonjë vendim për lartësinë e bursës studentore, edhe pse ekziston një rregullore e brendshme, por e cila nuk e cakton lartësinë e bursave.

**Rreziku** Ekzekutimi i pagesave nga komuna pa një konfirmim se shërbimet e kontraktuara janë pranuar, rrisin rrezikun që të bëhen pagesa të parregullta dhe objektivat e marrëveshjeve të arrihen pjesërisht apo edhe të mos arrihen. Derisa komuna nuk ushtron mbikëqyrje aktive në realizimin e projekteve dhe nuk posedon asnjë garanci se OJQ-ja do të përfundojë projektet sipas marrëveshjeve, këto pagesa konsiderohen të parregullta. Mangësitë në rregulloren e brendshme për ndarjen e bursave shkaktojnë paqartësi lidhur me vlerën dhe procedurat e ndarjes së bursave.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë që marrëveshjet mes komunës dhe OJQ-ve të rishqyrtohen. Duhet të sigurohet se subvencionimi bëhet në harmoni të plotë me rregulloren për subvencione të komunës dhe çdo shmangie nga kjo rregullore do të analizohet dhe gabimet të korrigojnë. Rregulloret e komunës duhet të jenë të qarta dhe të përcaktojnë kriteret dhe shumën e lejuar për të bursave.

#### **Çështja 8 - Shpenzimet për udhëtime jo sipas Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative - prioriteti i lartë**

**E gjetura** Dy nga katër personat që kanë udhëtuar në udhëtim zyrtarë në Gjermani në shtator 2015, me Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Asamblesë Komunale, nuk janë të punësuar në administratën Komunale të Suharekës, për të cilët komuna ka paguar biletat dhe shpenzimet e tjera të udhëtimit zyrtarë.

Komuna kishte paguar shpenzimet në vlerë prej 5,000€ për ekskursion në Shqipëri për 125 punëtorë të komunës (30.04.2015 - 03.05.2015).

**Rreziku** Pagesa e shpenzimeve të udhëtimit zyrtarë për persona që nuk janë zyrtarë të komunës e rritë rrezikun e humbjes së parasë publike. Pagesa e ekskursioneve dhe dhënia e dhuratave për stafin e komunës është në kundërshtim me Ligjin dhe rregulloret mbi shpenzimin e parave publike.

**Rekomandimi 9** Kryetari të sigurojë se udhëtimet zyrtare jashtë bëhen vetëm sipas Udhëzimeve për udhëtime zyrtare dhe se nuk bëhen pagesa jashtë shpenzimeve të parapara me këto udhëzime. Kryetari të sigurojë se të gjithë të punësuarit në komunë kompensohen për punën vetëm sipas ligjit.

### 3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive. Shpenzimet në paga gjatë vitit 2015 ishin 7,759,732€ apo 100% e buxhetit të planifikuar.

---

#### Çështja 9 - Parregullsi në rekrutimin e personelit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Mungesa e kontrolleve të brendshme në rekrutimin e personelit arsimor ka rezultuar në mangësitë në vijim:
- Nga 12 mostra të audituara të rekrutimit në arsimin e komunës, pesë (5) prej tyre ishin punësuar pa një proces të rekrutimi.
- Rekrutimi në QKMF i doktorit të mjekësisë ishte bërë pa dëshmuar përvojën e punës që ishte kriter bazë i konkursit. I rekrutuari lidhur me përvojat e punës kishte sjellur dëshmi pas fillimit të punës në QKMF.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve të brendshme në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve lidhur me personelin dhe kategorinë Paga dhe mëditje shpie drejt rrezikut të kontestimit të pozitive të shpallura, dhe mund të shkaktojë humbje financiare për komunën, por njëherit rrezikon që të mos jenë rekrutuar kandidatët ma të mirë për pozitat vakante.
- Rekomandimi 10** Kryetari të ndërmarr masa konkrete për të siguruar një raportim të rregullt të departamenteve dhe të siguroj raporte përmbledhëse nga departamenti i burimeve njerëzore dhe të siguroj një proces të rregullt lidhur me rekrutimin dhe menaxhimin e personelit në komunë.

### 3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Komuna gjatë vitit 2015 kishte subvencionuar entitete jo-publike dhe përfitues individual në vlerë prej 286,746€ dhe pothuajse në tërësi kishte shpenzuar buxhetin në dispozicion për këto qëllime. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

---

## Çështja 10 - Krite të mangëta të Rregullores dhe mungesë raportimi nga përfituesit e subvencioneve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Rregullorja e brendshme e komunës për ndarje të subvencioneve nuk kishte të vendosura krite të qarta për ndarjen e subvencioneve.

Janë paguar 1,330€ për subvencionim të aktiviteteve kulturore për pesë (5) personat pjesëmarrës në manifestimin letrarë në Kukës pa u bazuar në një analizë të shumës së nevojitur apo një plani konkret lidhur me shpenzimet e shoqatës 'Elena Gjika Dora D'Istria' lidhur me këtë aktivitet. Njëherit, komuna nuk kishte informata se kush ishin pjesëmarrësit në këtë aktivitet dhe për çka ishin përdorur fondet e komunës.

Aktvendimi për Ndarjen e Subvencionit për SHKA 'Jehona' në vlerë 2,400€ ishte në kundërshtim me nenin 8 të rregullores së brendshme për subvencione sepse pjesa më e madhe ishte paguar për Ansamblin "SHOTA" dhe nuk i dedikohet grupeve Artistike të Suharekës.

Subvencionimi i një pjese të biletave të udhëtimit në vlerë të përbashkët 1,500€, për dy studentë (vetëfinancim i studimeve në SHBA) dhe (fitues i bursës në SHBA për studime) është në kundërshtim me rregulloren e brendshme për subvencione Neni 7 paragrafi 3 "qëllimi i bursave është për studentët në universitete publike të Republikës së Kosovës (për fëmijë të dëshmorëve dhe raste sociale)". Përfituesit e këtyre subvencioneve nuk kishin plotësuar asnjërin nga këto krite.

Në dy raste të përfitimit të subvencionit për nevoja shëndetësore vlera 1,500€ dhe 500€, ne kemi gjetur se vendimet nuk janë të bazuara sipas Nenit 12 të rregullores komunale në fuqi për ndarjen e subvencioneve.

Kompensimi për dëmet nga fatkeqësitë natyrore në vlerë prej 644€ i është dhënë përfituesit i cili nuk ishte në listën e aprovuar për t'u kompensuar lidhur me dëmet.

**Rreziku** Mangësitë në menaxhimin dhe dhënien e subvencioneve rrisin rrezikun që fondet të mos shpenzohen në pajtim me qëllimet e dedikuara. Aprovimi/refuzimi i kërkesave për subvencione në mungesë të kriterëve të qarta për ndarjen e tyre, rritë rrezikun e subjektivizmit dhe transparencës në ndarjen e subvencioneve dhe mos arrijen e objektivave të përcaktuara.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të vendosë krite të qarta lidhur me trajtimin e kërkesave për subvencione. Të sigurohet që me rastin e subvencioneve të lejuara të kërkohen që të përpilohen raporte përshkruese bashkangjitur me dëshmi dhe fatura për arsyeshmërinë e shpenzimeve dhe të përcillen aktivitetet për të cilat është lejuar subvencion.



## 3.6 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2015 ishin 1,816,000€, apo shprehur në përqindje rreth 86% e buxhetit të planifikuar. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative dhe të tjera. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së të hyrave dhe sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimeve.

---

### Çështja 11 - Planifikim jo i duhur dhe mos barazim i të hyrave - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për vitin 2015, ngarkesa për tatimin në pronë ishte 688,413€, ndërsa janë inkasuar 557,026€ prej të cilave 29,084€, kishin qenë kamata dhe dënime si dhe 141,502€ pagesa të tatimit nga vitet paraprake, që do të thotë se vetëm 56% të shumave të ngarkuara për vitin 2015 ishin inkasuar.

Nga listat e pranuar nga komuna për faljen e borxheve, kemi gjetur se ishin falur borxhet e qirasë për pronën komunale në vlerë 9,989€, duke u bazuar në ligjin për faljen e borxheve. Ky ligj nuk e parasheh faljen e borxheve për qiratë.

Të hyrat nga tatimi në pronë sipas sistemit në Ministrinë e Financave janë më të larta se ato të regjistruara në SIMFK për shumën prej 2,196€. Deri në fund të auditimit, përpjekjet për harmonizimin e diferencave në mes të komunës dhe Ministrisë së Financave nuk kanë rezultuar me sqarimet e kërkuara.

Gjatë rishikimit të planit për tatimin në pronë, kemi identifikuar se nuk është përfshirë në plan verifikimi i 1/3 së territorit për rivlerësim të pronave, siç kërkohet me Udhëzimin administrativ nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave të tatimit në pronë.

**Rreziku** Mos barazimi i totalit të të hyrave nga tatimi në pronë me totalin e paraqitur në PVF e rritë rrezikun që komuna të mos mund të kontrollojë në plotësi sistemin e të hyrave vetjake. Më tej, mos verifikimi i objekteve limiton marrjen e informacionit për bazën reale të ngarkesave me tatime dhe të shkaktoj humbje financiare për komunën. Falja e borxheve të qirasë pa bazë të qartë ligjore shkakton humbje financiare për komunën.

**Rekomandimi 12** Kryetari të vendosë kontrole të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, barazimit dhe raportimit të të hyrave vetjake. Gjithashtu, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzojë të gjitha burimet për verifikim të pronave sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative. Falja e borxheve të bëhet bazuar në ligjet në fuqi dhe vendimeve të bazuara në rregullore.



## 3.7 Pasuritë

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Komuna e Suharekës kishte bërë përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive komunale sipas rekomandimit të dhënë vitin e kaluar.

Vlera neto e pasurisë së regjistruar në SIMFK në vitin 2015 ishte 281,787,175€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale nën 1,000€ ishte 2,512,000€, vlera të cilat edhe janë shpalosur në PVF.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7.2 Trajtimi i Llogarive të arkëtueshme

Komuna nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, të hyrat nga qiratë dhe taksat e aktivitetit të biznesit. Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave të grumbulluara, ka rezultuar me nivele të larta të llogarive të arkëtueshme. Megjithatë, vlen të theksohet se ligji për faljen e borxheve mund të ketë ndikuar në rënien e normës së inkasimit të borxheve të mbetura nga vitet e kaluara.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 12 – Nën deklaram i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna, në vitin 2015 ka deklaruar vlerën prej 2,577,000€ të llogarive të arkëtueshme, që krahasuar me vitin 2014 ishte 4,212,000€, pra borxhet ndaj komunës janë zvogëluar për 1,635,000. Vlerën më madhe të këtyre e paraqesin të arkëtueshmet nga tatimi në pronë të cilat në fund të vitit fiskal arrinin vlerën prej 2,149,000€.

Ne kemi vërejtur zvogëlim domethënës të këtyre llogarive nga viti 2014 në vitin 2015. Nga diskutimet me zyrtarët e komunës ne kemi gjetur se kjo diferencë e madhe është prezantuar gabimisht në PVF për shkaqe teknike dhe se e njëjta do të përmirësohet në PVF të vitit vijues 2016. Ne kemi vërejtur moskonsistencë si në rastet e paraqitura më poshtë:

- Tek rentat nga 104,000€ sa ishin në vitin e kaluar, në 38,000€ ndërsa arkëtimi gjatë vitit ishte 50,000€. Diferenca e zvogëluar për 16,000€ është e pa qartë;
- Qiraja nga 247,000€ sa ishin në vitin e kaluar, në 63,000€ ndërsa arkëtimi gjatë vitit ishte vetëm 46,000€. Nuk ka shpjegime për diferencën e zvogëluar prej 138,000€;
- Taksat komunale nga 1,686,000€ sa ishin në vitin e kaluar, në 327,000€ ndërsa, arkëtimi gjatë vitit ishte 715,000€. Diferenca e pa sqaruar është 644,000€.

### **Rreziku**

Zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme në PVF në vlerë prej 798,000€, për arsye të gabimeve teknike e rritë rrezikun që pasqyrat financiare të mos jenë të besueshme. Zvogëlimi i këtyre llogarive rritë rrezikun e mos prezantimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF dhe mundë të shkakton humbje të konsiderueshme financiare për komunën. Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, mund të rezultojë me rritjen e mëtejme të këtyre llogarive, dhe rrjedhimisht edhe me efektin që burimet vetjake të financimit të mos planifikohen mirë.

### **Rekomandimi 13**

Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që me zyrtarët përgjegjës financiar të shqyrtoj arsyet e mos prezantimit në PVF të këtyre llogarive. Procesi i monitorimit sistematik të bilanceve, masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit. Ne, në auditimin e radhës do të kemi në vëmendje të veçantë masat që ka marrë menaxhmenti në trajtimin e këtij problemi dhe do të nxjerrim konkluzionet e duhura.

### 3.7.3 Trajtimi i Llogarive të pagueshme

Detyrimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishin 94,732€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Komuna nuk kishte një sistem të definuar për menaxhimin e llogarive të pagueshme. Sqarimi për mos pagesën me kohë ishte mungesa e buxhetit, ndërsa, në fund të vitit 2015, komuna kishte suficite buxhetore prej 442,000€, të hyra vetjake të cilat janë bartur në vitin 2016.

---

#### Çështja 13 - Mos prezantim i plotë i faturave të papaguara - Prioritet i lartë

**E gjetura** Obligimet e vitit 2015, janë rritur në vlerën 94,732€ apo 98%, nga obligimet e vitit 2014 që ishin 47,886€.

Po ashtu, komuna përballet edhe me detyrime kontingjente në vlerë 148,000€, nga pretendues të ndryshëm.

Fatura e paguar me datën 08.06.2015 në vlerë 26,639€, nuk kishte qenë e paraqitur në PVF si obligim i vitit 2014.

**Rreziku** Rritja e obligimeve të papaguara dhe niveli i lartë i detyrimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Mungesa e një sistemi të qartë për menaxhimin e Llogarive të Pagueshme dhe mos prezantimi i plotë i të gjitha obligimeve të papaguara të komunës ndikon edhe në prezantim jo të drejt të PVF.

**Rekomandimi 14** Kryetari të kujdeset që të gjitha faturat paguhen me kohë sipas kontratave dhe obligimet e mbetura pa paguar prezantohen saktë në raportet financiare të komunës. Kryetari duhet të rishikoj sistemin e menaxhimit të detyrimeve të papaguara, për t'iu shmangur ekzekutimin direkt të pagesave nga MF dhe gjykatat.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo të implementuar	Të pa adresuara
Pasqyrat Financiare	<p>Për vitin 2015 Kryetari i Komunës të sigurojë një dialog të shtuar me Ministrinë e Financave për ta përcaktuar një zgjidhje të pranueshme për ta evituar keq klasifikimin material.</p> <p>Kryetari duhet ta prioritzojë kompletimin e një inventarizimi të tërësishëm në vitin 2015 për ta konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e shifrave të pasurive në PVF.</p>	Po, inventarizimi është kompletuar.	<p>Kryetari i Komunës ne vijim do të bashkëveproj me Ministrinë e financave që në qarkoren buxhetore buxhetore 1 dhe 2 te lejohen mjetet të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe subvencione me qellim të evitimit të keq klasifikimeve të shpenzimeve. Është inkurajuese se një veprim në adresimin e këtij rekomandimi ka filluar me rastin e përgatitjes së projekt buxhetit fillestar të organizatës buxhetore.</p> <p>Ne vijim edhe pse komisionet për inventarizim janë formuar me kohë me qëllim që inventarizimi i pasurive fikse si dhe harmonizimi i informacioneve të pasurive me regjistrin e pasurive financiare dhe jo financiare të procedohet para dorëzimit të PFV të komunës po ashtu do të vendosim një kontroll dhe monitorim ma rigoroz që ky rekomandim të adresohet dhe të mos përsëritet edhe në vijim.</p>	Jo Keqklasifikimet kanë ndodhur edhe në vitin 2015 dhe shpalosje të keq klasifikimeve nuk është bërë.



	<p>Të sigurohet që plani i hartimit të PVF 2015 të përfshijë rishikimin në hollësi të draft llogarisë nga Menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në të gjitha draft PVF-të janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme duke përfshirë këtu edhe një rishikim të dytë të pavarur të punës së ZKF-së.</p>		<p>Ne në vijim do të vendosim kontrolla edhe ma efikase të dizajnuara mirë që gjatë përgatitjes së Draft deklaratave financiare vjetore aty ku na lejojnë mundësit në marrjen e informacioneve të sakta dhe të besueshme në mënyrë që gabimet të mos përsëriten që do të rezultojë në mos korrigjimin e Pasqyrave vjetore financiare të komunës.</p>	<p>Jo Gabime ka vazhduar të ketë në PVF.</p>
<p>Rekomandimet e vitit paraprak</p>	<p>Plan veprimi i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Kur raporti i ZAP-it të diskutohet në Kuvend Komunal, Kryetari duhet t'i shtrojë barrierat për mos implementimin e plotë të rekomandimeve dhe asambleja duhet të sfidojë barrierat e mos implementimit të rekomandimeve dhe të kërkoj raporte të rregullta dhe të detajuara për progresin e implementimit të rekomandimeve.</p>		<p>Ne këtë planë të veprimit do të sigurojmë që të përcaktojmë afatet optimale që do të gjenerojnë një jetësim të plotë të rekomandimeve, dhe raporti do të diskutohet në asamblenë komunale dhe vërejtjet dhe sugjerimet e mara do të inkorporohen me rastin e rishikimit të planit të veprimit.</p>	<p>Pjeserisht - Nuk monitorohet formalisht zbatimi i rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë mbetur të pazbatuara.</p>

Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të bëj rishikim të rregullimeve ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies dhe të kërkesave shoqëruese të raportimit në komunë. Kërkesat e pazbatuara duhet të zbatohen deri në shtator 2015. Cilësia e çështjeve që ndërlidhen me këtë, si raportimi i brendshëm, duhet të rishikohen në mënyrë kritike për të demonstruar në Kuvendin Komunal që është aplikuar sfida efektive tek/nga zyrtarët për të siguruar një menaxhim efektiv operativ të komunës dhe arritjen e objektivave strategjike.		Edhe pse ne në këtë sistem kemi marr masa në adresimin e këtij rekomandimit ,ne vijim do të vendosim kontrolla edhe ma adekuate të projektuara në një nivel ma të lartë në identifikimin e rrezikut vlerësimin e rrezikut dhe vendosjen e kontrollave adekuat në menaxhimin e rrezikut me qëllim të arritjes së objektivave ma efikase dhe efektive si dhe sistemi i vetëvlerësimit duhet te funksionalizohet edhe me tej si dhe për sfida eventuale të diskutohen edhe në Kuvendin Komunal.	Pjesa e menaxhimit të rrezikut nuk është adresuar. Komuna nuk ka vendosur linja formale të raportimit.
Buxheti	Kryetari duhet të siguroj se performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për t'i përmirësuar nivelin e realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të rishikohet në buxhetin final.	Perqindja e realizimit të buxhetit ishte e lartë	Ne këtë sistem kemi treguar një prformancë të mirë në zvogëlimin e të pagueshmeve të bartura nga vitet e përparshme me rastin e rishikimit të buxhetit final. Ne vijim do forcojmë kontrollin edhe më tej i projektuar që sistemi i kontrollit të funksionoj edhe me tej ne zvogëlimin e obligimeve dhe realizimin e të hyrave vetjake me qëllim të përmbushjes së objektivave te përcaktuar dhe bartja e mjeteve vetjake te jete në nivel qe mundë të jetë i tolerueshëm dhe i justifikueshëm.	
Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që proceset e brendshme forcohen për të lejuar regjistrim të menjëhershëm dhe faturim të pronave të reja duke		Ne në vijim edhe përkundë mungesës së burimeve njerëzore në sektorin e tatimit ne pronë ,në vijim kemi forcuar dhe ne vazhdimësi monitorojmë regjistrimin e	Mangësi vazhdohet të këtë.

	<p>raportuar te Menaxhmenti për pikat kyçe të këtij procesi. Duhet të kihet në konsideratë edhe kontrollet e nevojshme që duhet implementuar për t'u siguruar se janë aplikuar plotësisht të gjitha udhëzimet administrative dhe kjo duhet të monitorohet vazhdimisht.</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ekzistuese ligjore me të gjitha kontratat e skaduara të ofruara në ankand të hapur. Ky proces duhet të monitorohet dhe të raportohet tek Kuvendi Komunal. Përveç kësaj, masa të nevojshme të inkasimit duhet ndermirën për maksimizuar nivelin e inkasimit.</p>		<p>objekteve ekzistuese dhe objekteve të reja mbështetur në kërkesat që rrjedhin nga Udhëzimet e tatimit në pronë. Një veprim i tillë është mjaft inkurajues se të gjitha regjistrimet e pronave të regjistruar deri në fund të muajit mars janë proceduar në bazën e tatimit në pronë për kalkulimin e faturave.</p>	
<p>Shpenzimet përmes prokurimit</p>	<p>Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të zbatojë kontrolle të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar.</p> <p>Kryetari duhet të shqyrtojë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këtë rast dhe të zbatojë kontrolle të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat;</p>		<p>Ne këtë rekomandim kemi filluar ta adresojmë. Të gjitha mundësit ligjore që lejojnë do të na mundësojnë që prona e komunës si dhe për kontratat e skaduar të u ofrohen dhe lejohen përmes Ankandit publik.</p> <p>Ne kemi vendosur kontrollat adekuat dhe progresi është mjaftë inkurajues që as një blerje nuk autorizohet pa siguruar paraprakisht sigurimin e mjeteve dhe të njëjtin veprim do ta vazhdojmë edhe në vijim</p> <p>.Prokurimi në bashkëpunim me njësit e</p>	<p>Mangësi vazhdohet të ketë.</p> <p>Mangësi vazhdohet të ketë.</p>

	specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale; dhe, furnizimet i reflektojnë kërkesat e drejtorive.		kërkesave do të bashkëveprojnë edhe me tej për një vlerësim edhe ma real të nevojave për furnizimi dhe shërbime të cilat më kohë do të inkorporohen në planifikimin e prokurimit të komunës. Edhe për kundër një progresi në adresimin e rekomandimeve në këtë sistem do te forcojmë kontrollin dhe do të vendosim politika dhe strategji edhe ma efikase që sistemi i prokurimit të zhvillohet në pajtueshmëri me LPP dhe ligjet sekondare.	
Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet t'i rishikojë të gjitha marrëveshjet ekzistuese për bashkëfinancim për të përcaktuar pse nuk janë përmbushur kërkesat ligjore dhe të shikojë ta rregullojë pozicionin si një çështje urgjente. Të gjitha marrëveshjet e mirëkuptimit duhet të azhurnohen për të siguruar transparencë dhe mekanizma efektiv monitorues për të dhënë siguri se kontributet e komunës sigurojnë vlerë për paranë, po shpenzohen sipas qëllimit dhe po mbështeten nga dëshmitë adekuate.		Ne në këtë sistem të parashikimit të kontratave të parashikuar të përgatitura nga njësit e kërkesave do te vendosim kontrollera edhe ma rigorozë qe asnjë porosi të mos autorizohet pa siguruar paraprakisht nga prokurimi specifikimet teknike. Porosit të autorizohet sipas çmimeve ma të lira të përcaktuar në specifikime teknike dhe të kontraktuar nga ana e komunës. Një veprim i tillë ka filluar të implementohet.	Mangësi vazhdohet të ketë.
Subvencione dhe Transfere	Kryetari të sigurojë se të gjitha subvencionet janë subjekt i monitorimit efektiv duke i përcaktuar kërkesat për raportim të përfituesve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve në vendimet për subvencionim. Aty ku		Ne në këtë sistem kemi filluar të ndërmarrim veprime efikase që të gjitha pagesat e realizuar nga ana e komunës të kenë siguruar vlerën për para,transparencë si dhe do të sigurojmë qe asnjë pagesë të mos realizohet pa	Mangësi vazhdohet të ketë.

	kërkesat nuk respektohen masa adekuate duhet të ndermirën, si suspendimi i pagesave.		siguruar informacione të domosdoshme dhe të dokumentuar mirë që edhe bashkë financuesi i ka përmbushur zotimit e përcaktuar dhe të firmosura në marrëveshje të mirëkuptimit. Ne në vijim do te forcojmë kontrollin aty kë lejohet mundësia qe asnjë pagese të mos procedohet pa siguruar paraprakisht raporte narrative (shpjeguese) financiare të cilat mbështeten me fatura kuponë apo diçka të ngjashme.	
të arkëtueshmet	Kryetari të siguroj një shqyrtim rigoroz të të arkëtueshmeve për të përcaktuar çka mund të mblidhet dhe të aplikojë masat ligjore për maksimizimin e niveleve të inkasimit.		Ne vijim do te forcojmë kontrollin dhe të bashkëveprojmë edhe departamentet tjera një veprim edhe ma efikas në zvogëlimin e të arkëtueshmeve.	Mangësi vazhdohet të ketë.
Auditimi i brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se arsyet për nivelin e ulët të adresimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm analizohen dhe të inicioj përgatitjen e planeve të veprimit për adresimin e rekomandimeve, duke përfshirë kohën dhe stafin kyç përgjegjës. Komiteti i auditimit duhet ta monitorojë zbatimin e rekomandimeve, dhe aty ku është e nevojshme, të kërkojë shpjegime për moszbatim.		Ne në vijim të forcojmë kontrollin në nivel të Drejtoreve të cilët kanë qenë nen auditim të brendshëm dhe dot të mbështesim dhe angazhojmë edhe komitetin e auditimit në zbatimin e plotë të rekomandimeve të auditorit të brendshëm.	Niveli i implementimit te rekomandimeve është ende i vogël. Komiteti i Auditimit nuk kishte qene mjaft funksional gjate vitit 2015.